



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:012071

Datë: 09.12.2024

Numri i dokumentit: 06565663

**C-IV-14-7120**

*Parashtruesi i kërkesës*

**D E, Mitrovicë**

*Kundër*

*Pala kundërshtare*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit – (AKP) (NSH “Fabrika e Duhanit” në Likuidim) Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtinë.**

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 9 dhjetor 2024, lëshon këtë:

**AKTGJYKIM**

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit MIT049-0004 datë 22 tetor 2014.**
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 21 nëntor 2014, pranë DHPGJS-së, ankuesi parashtroj kërkesë, të emërtuar ankesë, për rishqyrtimin e vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) MIT049-0004 datë 22 tetor 2014 (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi), me të cilin kërkesa për kompensimin pjesëmarrjes së pronësisë në shumë të pacaktuar, ndaj N.SH “Fabrika e Duhanit” (në likuidim) është refuzuar.

Ankuesi kundërshtoj Vendimin e AL për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, shkeljeve procedurale si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë gjendjes faktike.

Ankuesi konsideron se me rastin e vërtetimit të gjendjes faktike AL me vendimin e saj ka bërë shkelje elementare me çka i është pamundësuar qasja në drejtësi e që përbën shkelje të nenit 6 në lidhje me nenin 1 të Protokollit të Konventës Evropiane mbi liritë dhe të drejtat e njeriut – KELDNJ si dhe nenit 14 të KELDNJ, dispozita të aplikueshme sipas nenit 24 dhe 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Ankuesi tutje i referohet shkeljeve të parapara sipas nenit 9.2 të Ligjit mbi procedurën administrative, mbi informimin në kohë të arsyeshme,

Ankuesi pohon se si rezultat i rrethanave të njohura botërisht ishte i detyruar që të lëshoj vendin e tij të punës për shkak të sigurisë dhe jo me vullnet të tij. Në të kundërtën, sipas ankuesit, do të vazhdonte me punë dhe detyra pranë NSH. Ankuesi, në vazhdim i referohet vendimit të kësaj gjykate, SCEL-09-0007 nga data 16 dhjetor 2010. Ankuesi në vijim pohon se asnjëherë nuk ka pranuar vendim mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Ankuesi i referohet Vendimeve të Gjykatës Evropiane mbi Liritë dhe të drejtat e njeriut, lidhur me aplikimin e nenit 1 protokolit 1 të KELDNJ si dhe nenit 156 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Nga të gjitha arsyet ankuesi propozoj që Vendimi i AL të priset dhe çështja të kthehet në rivendosje ose që kërkesa mbi kompensimin të aprovohet si e bazuar.

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL,
- Kopja e listës së punëtorëve mbi aksionet e regjistruara me zbritje dhe pa zbritje të NSH ( ashtu siç edhe thuhet në këtë listë),
- Kopja e kërkesës kreditore e parashtruar pranë AKP,
- Kopje të komunikimeve (e-maileve) të zyrtarëve të Agjencisë, dhe
- Kopja e shkresës, datë 6 shkurt 2008, drejtuar Agjencisë.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 31 korrik 2024, parashtroj përgjigjen.

AKP kundërshtoj në tërësi pohimet e ankuesit duke i konsideruara si të pabazuara. AKP pohon AL me rastin e vendosjes ka bërë një vlerësim të saktë të gjendjes faktike dhe se dispozitat materiale i ka aplikuar drejtë. AKP tutje pohon se kërkesa për rishikim- ankesa nuk përmban argumentet ligjore, ashtu siç parashihet sipas Shtojcës së Ligjit për AKP. AKP konsideron se kërkesa e ankuesit konsiderohet e pabazuar dhe e parashkruar ashtu siç parashihet sipas dispozitave ligjore të Ligjit për punën e bashkuar – LPB. AKP i referohet vendimeve dhe praktikës gjyqësore të gjykatës. AKP gjithashtu me përgjigje i referohet edhe vendimeve të Gjykatës Evropiane mbi liritë dhe të drejtat e njeriut. Nga të gjitha arsyet e cekura, AKP-ja propozon që kërkesa për rishikim-ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe që Vendimi i AL të vërtetohet.

Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës, ankuesi përmes zyrës për ndihmë juridike nga Ministria e Drejtësisë, me 3 shtator 2024 parashtroj përgjigjen ndaj përgjigjes së AKP.

Ankuesi mbeti në tërësi si pranë kërkesës për rishikim-ankesës. Kundërshtoj përgjigjen e AKP si të pabazuar. Edhe me këtë përgjigje pohon se vendin e punës nuk e ka lëshuar me vullnetin e tij por për shkak të shkaqeve të sigurisë; se vendi i punës asnjëherë nuk i është ndërprerë andaj edhe çështja e parashkrimit nuk mund të aplikohet dhe përfundimisht konteston aplikimin e dispozitave nga AL mbi parashkrimin. Nga gjitha arsyet propozon që kërkesa e tij të aprovohet. Përgjigjes i është bashkangjitur kopja e Vendimit, nr. 33/24-12 datë 23 gusht 2024, me të cilin është aprovuar kërkesa e ankuesit mbi ndihmën juridike falas.

### **Arsyetimi Ligjor**

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit Nr.06/L-086 të DHPGJS në lidhje me nenin 399 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore, gjykata përcakton se faktet relevante të rastit janë të pakontestueshme dhe nxjerrë këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtrësit e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsyetimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e tij. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një

fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Nga dispozita e cekur si më lartë, është obligim i ankuesit që të dëshmoj detyrimet ndaj tij, respektivisht të drejtën për kompensimin e pjesëmarrjes së pronësisë së NSH.

Ankuesi për më tepër nuk ka dëshmuar të drejtën e tij në akcione, me fletë akcion ( dividendë dhe të drejtat tjera pronësore si aksionar), ashtu siç parashihet sipas Ligjit mbi ndërmarrjet me ndryshime dhe plotësime (gazeta zyrtare e RSFJ nr. 77/88, 40/89, 46/90 dhe 61/90); Ligjit mbi kapitalin shoqëror (gazeta zyrtare e RSFJ nr. 84/89 dhe 46/90) dhe Ligjit mbi plotësimet dhe ndryshimet e ligjit mbi kushtet dhe procedurat e transformimit në forma të ndryshme të pronësisë ( gazeta zyrtare e R.S. nr. 49/91, 75/91 dhe 51/94), ligje këto të zbatueshme sipas Rregullores së UNMIK-ut 1999/24 për Ligjin e zbatueshëm në Kosovë.

Për më tepër, ashtu siç qëndron në arsyetimin e Vendimit të AL, ankuesi ishte i obliguar që në procedurën pranë AL të dëshmoj të drejtat e tij në aksione, ashtu siç qëndron sipas nenit 36 paragrafi 2 pika 2, e Shtojcës së Ligjit për AKP.

Ankuesi gjithashtu, edhe në procedurën e shqyrtimit të ankesës së tij, ashtu siç parashihet sipas dispozitave të cekura si më lartë të Ligjit për DHPGJS, nuk ka parashtruar dëshmi mbështetëse të cilat do ti argumentonin pohimet e tij.

Një listë e parashtruar, si ajo e listës së punëtorëve mbi aksionet e regjistruara me zbritje dhe pa zbritje të NSH, nuk paraqet provë të mjaftueshme mbi të drejtat pronësore ndaj NSH.

Andaj, nga të gjitha të lartë cekura, ankuesi nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi kompensimin siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.5 dhe 1.7 por edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS

Barra e provave bie mbi ankuesin që të dëshmon të drejtat e tij, sipas dispozitave të lartëcekura ligjore.

Gjykata, gjithashtu, konsideron se AL me rastin e Vendosjes nuk ka vepruar në kundërshtim me KELDNJ.

Andaj, nga të gjitha arsyet, u vendos si në dispozitiv.

### **Taksa Gjyqësore:**

Kërkesa kreditore është në shumë të paspecifikuar.

Në bazë të nenit 6 të Ligjit për DHPGJS secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

**Këshillë Juridike:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

---

Gazmend Sylaj, Gjyqtar



**C-IV-14-7120**  
*Podnosilac zahteva*

**D E**, Mitrovicë

*Protivu*

*Suprotna stranka*

**Kosovske Agencija za Prvatizaciju – (KAP) ( DP “Fabrika Duvana”** u likvidaciji), Ul. “Dritan Hoxha”, br. 55, Lakrište, Priština.

Posebna komora Vrhovnog suda Kosova za pitanja vezanim za Kosovsku agenciju za Privatizaciju (PKVSK), sudija Gazmend Sylaj, dana 9 Decembra 2024 godine. donosi sledeću:

### **PRESUDU**

- I. Žalba žalioca odbija se kao neosnovana.**
- II. POTVRĐUJE se rešenje Organa za Likvidaciju MIT049-0004 od 22 Oktobra 2014.godine.**
- III. Svaka stranka snosi svoje troškove.**

### **Činjenične i proceduralne okolnosti**

Dana 21 Novembra 2014 godine, pri PKVS, žalilac je podneo zahtev, navedenu kao žalbu, o preispitivanju rešenja Organa Likvicaje (OL) MIT049-0004 od 22 Oktobra 2014 godine ( u daljem tekstu Rešenje) kojim je zahtev kompenzacije učešća vlasništva, u neodređenom iznosu, nad DP “Fabrika Duvana” ( u likvidaciji) odbijen

Žalilac se usprotivio Rešenju OL zbog pogrešne primene materijalnog prava, povrede postupka i pogrešnog i nepotpunog utvrđivanja činjeničnog stanja.

Žalilac smatra da prilikom utvrđivanja činjeničnog stanja OL svojim rešenjem je učinjeno elementarno propuste a ka posledica je onemogućeno pristup praviđ što sačinjava povredu članu 6 u vezi člana 1 Protokola Evropske Konvencije o ljudskim pravima – EKLJP kao i članu 14 EKLJP, odredbe u primeni po članu 24 i 31 Ustava Republike Srbije.

Žalilac dalje se referisao povredbama po članu 9.2 Zakona o upravnom postupku, o informaciju u razumnom roku.

Žalilac je naveo da kao posledica opšte poznatih razloga bio primoran da napusti svoje radno mesto zbog bezbednosti a ne svojom voljom. U protivnom, po žalioacu, bi nastavio sa radom i radnim zadacima pri DP. Žalilac, dalje se referisao odluci ovog suda, SCEL-09-0007 od 16 Decembra 2010 godine. Žalilac dalje je naveo da nikada nije primio rešenje o prekidu radnog odnosa.

Žalilac se referisao Odlukama Evropskog suda o ljudskim pravima, u vezi primene člana 1 Protokolla 1 EVLJP kao i članu 156 Ustava Republike Kosova.

Iz svih razloga žalilac je predlagao da se Rešenje OL ukida i da se predmet vrati na ponovno odlučivanje il da se zahtev o kompenzaciji usvoji kao neosnovanim.

Sa zahtevom o preispitivanju su priloženi:

- Kopija Rešenja OL,
- Kopije liste radnika upisanih deonica sa popustom i bez popusta DP ( kao što je navedeno i rčeno u ovoj listi),
- Kopija proverilačkog zahteva podneto pri KAP,
- Kopije komunikacije (e-mailova) zvaničnika Agencije, i
- Kopija dopisa, od 6 Februara 2008, podneto pri Agenciju.

Postupajući po nalogu suda, KAP je dana 31 Jula 2024 godine podnela odgovor.

KAP se usprotivila u celosti sa navodima žalioaca smatrajući kao neosnovane. KAP je navela da OL prilikom odlučivanja pravilno je procenila činjenično stanje i da materialne odredbe pravilno primenila. KAP je dalje navela da zahtev o preispitivanju- žalba ne sadrži zakonske dokaze, kao što je predviđeno po Aneksu Zakona o KAP-u. KAP smatra da zahtev žalioaca smatra neosnovanim kao i zastarevanim kao što je predviđeno po zakonskim odredbama Zakona o udruženom radu – ZUR. KAP se referisao odlukama i sudskoj praksi suda. KAP također se referisao i odlukama Evropskog Suda o ljudskim pravima. Iz svih razloga, KAP je predlagala da se zahtev o preispitivanju- žalba odbije kao neosnovana i da se Rešenje OL potvrđuje.

Postupajući sa nalogom suda, žalilac preko kancelarije za pravnu pomoć od Ministarstva Pravde, od 3 Septembra 2024, podneo odgovor nad odgovorom KAP-a.

Žalilac je ostao u celosti ka pri zahtevu za preispitvanje-žalbu. Usprotivio se odgovoru KAP-a kao neosnovanim. I ovim odgovorom naveo da svoje radno mesto nije napustio svojim voljom ali zbog bezbednostih razloga; da je njegovo radno mesto nikada nije prekinuto stoga i pitanje zastarevanja ne može se primeniti i konačno prigovarao primenu odredaba OL o zastarevanju. Iz svih razloga je predlagao da se njegov zahtev usvoji.

Sa odgovorom je priloženo kopija Rešenja, br. 33/24-12 od 23 Avgusta 2024 godine, kojim je usvojen zahtev žalioaca o besplatnoj pravnoj pomoći.

### **Pravnoobrazloženje**

Zahtev o preispitivanju - žalba smatra se neosnovanim.

Na osnovu člana 76.3 Zakona o PKVSK (zakon br.06/L-086 ) u vezi člana 399 Zakona o parničnom postupku, sud nalazi da relevantne činjenice predmeta su neosporne i ovu presudu izdaje bez zakazanja ročišta.

U konkretnom slučaju po članu 31 tačka 4 i 5 kao i člana 35 tačka 2.4 Zakona o PKVSK, obaveza je stanke, u ovom slučaju žalilji da u svojim pismenim podnescima, žalbi, podnese sva iscrpnie činjenice i pravno obrazloženje na kojima temelje svoje stavove i argumente. U slučaju kada stranka navodi, u ovom slučaju žalilac, postojanje neke činjenice, ta stranka je dužna da predloži dokaze, fizičke i/ili podneske na osnovu kojih bi dokazivali svoje navode.

Iz gore navedene odredbe, je obaveza žalioaca do dokazuje obavezu nad njom, odnosno pravo o prava o nadoknadi učešća svojine DP.

Žalilac što vise nije dokazivao njegovo pravo nad deonicama, sa deonicama ( dividendom i njegovo svojinsko pravo kao deoničar), kao što je predviđeno po Zakonu o preduzečima sa dopunama i izmenama (službeni list SFRJ br. 77/88, 40/89, 46/90 dhe 61/90) Zakonu o društvenom kapitalu ( službeni list SFRJ br. 84/89 i 46/90) kao i Zakonu o dopunama i izmenama zakona o uslovima i postupcima transformacije u drugim vidovima transformacije nepokretnosti ( službeni list R.S. br. 49/91, 75/91 i 51/94), zakoni u primjeni po UNMIK Uredbi 1999/24 o Zakonu o Primjeni u Kosovu.

Što vise, kao i što stoji u obrazloženju Rešenja OL, žalilac bio u obavezi da u postupku pri OL dokazivati njegovo pravo deoničara, kao što i stoji po odredbi člana 36 paragraf 2 tačka 2, Aneksa Zakona o PKVSK.

Žalilac također i u postupku razmatranja njegove žalbe, kao što je i predviđeno u smislu gore navedenih odredba Zakona o PKVSK, nije podneo iscrpne dokaza koji mbi dokazivao njegove navode.

Priloženim listom, kao što je liste raadnika upisanih deonica sa popustom i bez popusta DP, ne prestavlja dovoljan dokaz o pravima svojine nad DP.

Stoga, iz svih gore navedenih razloga, žalilac nije dokazivao pravo naknade kao što je predviđeno po članu 40 paragraf 1.5 i 1.7 , ANEKSA Zakona o KAP-ut ali i nije dokazivao neke ostale obaveza kao što je predviđeno po članu 31 tačka 4 i 5 i člana 35 tačka 2.4 Zakona o PKVSK.

Teret dokazivanja spada nad žalioцем da dokazuje njegovo pravo, po gore navedenim zakonskim odredbama.

Sud također, smatra da OL prilikom odlučivanja nije postpio u protivnosti sa EKLJP.

Stoga, sa svih razloga je odlučeno je kao u izreci.

### **Sudske takse**

Poverilački zahtev je u neodređenom iznosu.

U smislu člana 62 Zakona o PKVS, svaka stranka snosi svoje troškove.

Stoga je odlučeno kao u izreci.

### **Pravni lek**

Protiv ove presude može se podneti pismena žalba Apelacionom veću PKVS u roku od 15 dana od dana prijema ove presude. Žalba se mora podneti u skladu sa članom 9 stav 6 Zakona o PKVS.

(potpisano)  
Gazmend Sylaj, Sudija